



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 22 prill 2015

Nr. i lëndës 2011-20

X. dhe 115 ankues të tjerë

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 dhe 22 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Duke shqyrtuar ankesën e lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 9 qershor 2011.
2. Më pas, Paneli ka miratuar dëshirën e ankuesve që mos t'ju zbulohen emrat.
3. Më 20 qershor 2012, Paneli ka vendosur ta njoftoj shëfën e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë rreth ankesës, duke e ftuar atë që të parashtrojë komente me shkrim për ankesën. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 2 maj 2012. Më pas, ato u janë dërguar ankuesve për vërejtjet e tyre.

4. Më 5 qershor 2012, ankuesit kanë dorëzuar përgjigjen e tyre.
5. Më 5 tetor 2012, Paneli ka shpallur ankesën pjesërisht të pranueshme. Paneli ka shpallur të papranueshme ankesat që kanë të bëjnë me kushtet e përgjithshme të jetesës në kampet, ndotjen e mjedisit, dëmin e supozuar në shëndetin e ankuesve, kujdesit të pamjaftueshëm mjekësor dhe dështimi për t'i zhvendosur banorët e kampeve. Paneli ka ardhur në përfundimin se ato çështje nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, e cila nuk mbulon administrimin ose përgjegjësinë për administrimin e kampeve të PZhBV-së.
6. Paneli ka konstatuar se ankesat sipas nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe nenit 13 (e drejta për mjet efektiv) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa) ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe ligjit, përcaktimi i të cilave kërkon shqyrtimin e meritave. Paneli ka ftuar palët të paraqesin ndonjë vërejtje shtesë mbi meritat e lëndës.
7. Vërejtjet e palëve janë pranuar më 12 nëntor dhe 20 dhjetor 2012.
8. Më 9 janar dhe 2 korrik 2014, Paneli ka kërkuar nga ShM që të ofroj informacion shtesë rreth lëndës. Në veçanti, Paneli ka pyetur nëse ndonjë hetim penal lidhur me rastin ishte në pritje pranë autoriteteve të EULEX-it apo të Kosovës. Paneli ka marrë përgjigjet nga ShM më 27 janar dhe përkatësisht më 25 korrik 2014.
9. Më 27 gusht 2014, Paneli sërish ka kërkuar nga palët të ofrojnë vërejtje shtesë rreth meritave të lëndës. Ankuesit dhe ShM janë përgjigjur më 25 shtator dhe përkatësisht më 24 nëntor 2014.
10. Pasi që z. John Ryan ishte këshilltar i lartë ligjor në Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK-u) atëherë kur kjo lëndë e ankuesve ishte shqyrtuar nga ai Panel, tani ai nuk merr pjesë në procedurat që zhvillohen nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.

II. FAKTET

11. Faktet e lëndës, ashtu siç janë parashtruar nga ankuesit dhe siç duket nga dokumentet që iu janë paraqitur Panelit si dhe nga informatat e tjera përkatëse nga burime zyrtare, mund të përmbliidhen si në vijim.

Informata paraprake rreth kampeve të PZhBV-së

12. Gjatë konfliktit të vitit 1999, shumë romë nga mahalla e romëve (gjithashtu e njohur si Fabrika apo Mahalla në Mitrovicë) dhe pjesë të tjera të Kosovës kanë ikur drejt pjesës veriore të Kosovës si pasojë e dhunës ndëretnike dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre.

13. Rreth 600 romë, ashkali dhe engjiptas kosovarë të zhvendosur brenda vendit ishin vendosur në kampe për personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV).
14. Kampet Cesminlukë (në komunën e Mitrovicës) dhe Zhikoc (në komunën e Zveçanit) ishin themeluar nga zyra e komisionerit të lartë për refugjatë (UNHCR) në vitin 1999.
15. Kampi i tretë ishte ndërtuar në Leposaviq në vitin 1999, diku 45 kilometra larg Trepçës.
16. Në vitin 2001, kampi i katërt, kampi Kablare, ishte vendosur afër Cesminlukës. Dy kampet e para dhe kampi i katërt ishin vendosur 3 kilometra brenda shkretotës së Trepçës dhe 300 metra brenda dy deponive të minierës.
17. Kampi i pestë, kampi Osterodë, ishte një kamp ushtarak i ish Jugosllavisë i shfrytëzuar nga KFOR-i francez nga viti 1999-2005, ku pastaj ajo ishte shndërruar në një kamp për personat e zhvendosur brenda vendit ("PZhBV"). Kampi Osterodë kishte hyrë në funksion në vitin 2006. Ky kamp gjendej brenda qytetit të Mitrovicës.
18. Edhe pse kampet ishin ndërtuar si masë e përkohshme, për një kohë të gjatë përpjekjet për të gjetur banim alternativ ishin të pasuksesshme, pasi nuk mund të identifikoheshin ndonjë parcelë e përshtatshme nga autoritetet vendore për strehim të ri.
19. Kushtet e jetesës në kampet e PZhBV-së ishin shumë të këqija. Përpos kësaj, që prej vitit 2000 ishte konstatuar nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u), KFOR-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) se si pasojë e punimeve të mëhershme xehetare, toka në atë zonë ishte jashtëzakonisht e ndotur, posaçërisht nga plumbi. Shumica e personave që jetojnë në ato kampe kanë pasur përqindje të plumbit në gjak që i tejkalonte nivelet e pranuar mjekësore.
20. Romët që jetojnë në këto kampe dyshohet se ishin njoftuar rreth rreziqeve që i kanosej shëndetit të tyre nga helmimi me plumb jo më herët se në vitin 2005.
21. Kampi i Zhikocit dhe kampi i Kablarës janë mbyllur në vitin 2006.
22. Në vitin 2006, disa prej banorëve të kampit të Cesminlukës ishin zhvendosur në Osterodë. Disa banorë nuk kishin pranuar që të largoheshin për në Osterodë, pasi në atë kohë ata nuk mendonin se ai ishte zgjedhje më e mirë sesa vendbanimi i tanishëm i tyre.
23. Nga viti 2001 deri më 2008 UNMIK-u ishte përgjegjës për këto kampe. Në maj të vitit 2008, UNMIK-u për kampet e mbetura ia kishte

dorëzuar përgjegjësinë qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

24. Në janar të vitit 2009 ishte bërë dorëzimi i menaxhimit të kampeve të Cesminlukës dhe Osterodës nga Kisha Norvegjeze për Ndihma (Norwegian Church Aid) në një OJQ vendore, në Agjencinë Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KAAD), e financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Në prill 2009, zyra e kryeministrit në një deklaratë publike ka pohuar se do të merrej me problemin e ndotjes nga plumbi.
25. Përfundimisht, autoritetet vendore kosovare caktuan një parcelë të përshtatshme për ndërtimin e strehimoreve për familjet që jetonin në ato kampe. Projekti për risistemim, në mesin e të tjerëve, i financuar edhe nga Bashkimi Evropian dhe USAD-i, lejuan që kampi i Cesminlukës të evakuohej dhe shkatërrohej në tetor të vitit 2010. Kampi i Osterodës dhe Leposaviçit ishin mbyllur në dhjetor 2012, përkatësisht dhjetor 2013.

Informata paraprake rreth ankuesve

26. Ankuesit janë 116 familje rome dhe anëtarë të familjeve rome, të cilët kanë banuar në kampet e përmendura më lartë. Shumë prej ankuesve dyshohet se vuajnë nga sëmundje të shkaktuara nga plumbi.
27. Në kohën e paraqitjes së ankesës pranë Panelit në qershor të vitit 2011, shumica e ankuesve kanë treguar se adresat e tyre janë qoftë kampet e Cesminlukës, Osterodës apo Leposaviçit.
28. Paneli nuk është në dijeni se ku është aktualisht vendqëndrimi i ankuesve.

Procedura kundër KB-së

29. Më 10 shkurt 2006, ankuesit kanë parashtruar një ankesë pranë KB-së lidhur me Ankesat të Palës së Tretë për lëndime personale apo vdekje.
30. Më 4 korrik 2008, ata kanë parashtruar një ankesë në lidhje me kushtet e jetesës dhe problemet shëndetësore në pesë kampet e administruara nga UNMIK-u të përmendura më lartë pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj).
31. Më 5 qershor 2009, PKDNj-ja ka shpallur këtë ankesë pjesërisht të pranueshme. Më 11 gusht 2009, përfaqësuesi i posaçëm i sekretarit të përgjithshëm (PSSP) i KB-së kishte kundërshtuar pranueshmërinë e asaj lënde, duke u bazuar se nuk ishin shterur rrugët ligjore në dispozicion.
32. Më 17 tetor 2009, PSSP-ja ka lëshuar një udhëzim administrativ nr. 2009/1 duke zbatuar rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 rreth themelimit të PKDNj-së. Paragrafët e saj 2.1, 2.2 dhe 2.3

parashikojnë se çdo ankesë e re apo që është ende në pritje pranë PKDNj-së dhe e cila është apo që në të ardhmen mund t'i nënshtrohet Procesit apo Procedurave për Ankesa të Palës së Tretë të KB duhet të konsiderohet e papranueshme. Nëse një ankesë e tillë tashmë ishte shpallur e pranueshme, çështja duhej të rivlerësohej dhe të vendosej rishtas për të.

33. Për më tepër, udhëzimi administrativ ka kufizuar fushëveprimin e përkohshëm të kompetencave të PKDNj-së duke vendosur se asnjë ankesë e parashtruar pranë PKDNj-së nuk do të shpallet e pranueshme, nëse është parashtruar pas datës 31 mars 2010.
34. Në vendimin e datës 31 mars 2010, PKDNj-ja së pari ka shqyrtuar kundërshtimin e ri të pranueshmërisë që ishte bërë nga ana e UNMIK-ut dhe që vinte nga udhëzimi administrativ nr. 2009/1. Paneli përsërit se ka qenë në diskrecion të PSSP-së për të përcaktuar skemën rregullative të sistemit të ankesave të parashtruara në Panel, dhe se Paneli nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar përputhshmërinë e bazës ligjore të funksionimit të vet me standardet e të drejtave të njeriut. Paneli ka vënë në dukje se seriozisht mund të vihet në pikëpyetje nëse PSSP-ja ka pasur kompetencë për të ndryshuar disa prej parimeve kryesore që përfshihen në rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 përmes një udhëzimi administrativ, i cili përkundër faktit që është emëruar "duke u zbatuar" ka prekur ndjeshëm kuadrin ligjor të funksionimit të Panelit. Sidoqoftë, Paneli ka konstatuar se fakti qëndron se dispozitat e udhëzimit kanë përbërë bazën ligjore të funksionimit të PKDNJ-së. Paneli ka arritur në përfundim se për fat të keq Paneli nuk ka pasur juridiksion për t'u marrë me argumentet e ngritura nga ankuesit lidhur me joligjshmërinë e udhëzimit administrativ. Më tej është vërejtur se udhëzimi administrativ ka hequr kompetencat e PKDNj-së për të shqyrtuar nëse ankuesi para se ta parashtronte ankesën e tij pranë PKDNj-së kishte shterur të gjitha mjetet juridike. Për më tej, Paneli ka konstatuar se ankesat thelbësore të aplikantëve *prima facie* hyjnë brenda kuadrit të kompetencave të Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të KB-së, prandaj ishin dashur të shpallehin të papranueshme.
35. Për më tej, PKDNj-ja ka konstatuar se pasi të përfundon procesi i Ankesave të Palës së Tretë, ankuesit mund të kërkojnë nga PKDNj-ja të rihapin procedurat, pavarësisht prej afatit të fundit që ishte deri me datën 31 mars 2010, e cila ishte vendosur nga udhëzimi administrativ nr. 2009/1.
36. Më 25 korrik 2011, zyra e çështjeve ligjore të KB-së nuk ka pranuar të veprojë tutje në procesin e ankesave të palës së tretë, duke deklaruar se ajo ankesë ka qenë kundër administrimit të Kosovës nga UNMIK-u, sesa një ankesë për lëndim të personave romë.
37. Më 7 tetor 2011, ankuesit kanë kërkuar nga PKDNJ-ja t'i rihap procedurat.

38. Në qershor 2012, PKDNJ-ja ka pranuar kërkesën e ankuesve dhe ka rihapur procedurat dhe ka proceduar me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.
39. Tani për tani procedurat pranë PKDNJ-së janë të pazgjidhura.

Përfshirja e EULEX-it

40. Më 21 janar 2010, përmes një formulari në internet një përfaqësues i ankuesve kishte kërkuar takim me shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it për të diskutuar gjendjen në kampet e PZhBV-së në pjesën veriore të Kosovës.
41. Në të njëjtën ditë zyra për informim dhe informim publik e EULEX-it ishte përgjigjur në emër të ShM të EULEX-it se nuk do të caktohej ndonjë takim i tillë dhe se ajo çështje nuk hynte në kuadër të mandatit të EULEX-it.
42. Më 2 shkurt 2010, përfaqësuesi i ankuesve kishte dërguar një memorandum prej 46 faqesh tek kryeprokurori i EULEX-it, duke kërkuar hetim dhe ndjekje penale për krime të rënda që ishin dhe po kryheshin ndaj banorëve romë në kampet e PZhBV-së.
43. Më 4 shkurt 2010, kryeprokurori i EULEX-it është takuar me përfaqësuesin e ankuesve dhe e ka njoftuar atë se nuk do të nis asnjë hetim lidhur me veprën e dyshuar penale, pasi ajo lëndë bie jashtë kompetencave të EULEX-it. Gjithashtu ai ka këshilluar se sa i përket asaj çështje ata duhet t'iu drejtohen institucioneve vendore.
44. Më 21 nëntor 2013, zyra e prokurorisë themelore në Mitrovicë ka regjistruar një ankesë, të parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve. EULEX-i ka caktuar një prokuror për t'u marrë me rastin. Më pas, një ekip i përzier i prokurorëve të EULEX-it dhe të Kosovës ishte caktuar për këtë rast. Ekipi ishte takuar për herë të parë më 9 janar 2014. Prokurori vendor ka kërkuar kohë për t'i lejuar atij që të njihet me materialin dhe të vendos mbi hapat e mëtejshëm.
45. Një hetim ishte iniciua më 15 prill 2014.
46. Më 30 maj 2014, ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës ka hyrë në fuqi në mënyrë retroaktive nga 15 prilli 2014 (shih ligjin në fuqi më poshtë). Në pajtim me nenin 1. A (1) prokurorët e EULEX-it kanë autoritet të kryejnë hetime penale vetëm në rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është parashtruar para 15 prillit 2014 (shih ligjin në fuqi më poshtë). Në rastin konkret një hetim ishte iniciua saktësisht më 15 prill 2014 (shih par. 43 më lartë). Për këtë arsye lëndë nuk mund të konsiderohej si rast që është në vazhdim e sipër brenda kuptimit të

kësaj dispozite. Si pasojë, në një datë të pasaktësuar, hetimi ishte marrë përsipër nga prokurorët e Kosovës nga zyra e prokurorisë themelore në Mitrovicë.

47. Njëkohësisht, prokurori i EULEX-it, i caktuar më parë për rastin, i ka sugjeruar zyrës së prokurorisë themelore në Mitrovicë që të merr parasysh nëse çështja ka hyrë brenda juridiksionit të zyrës së prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës. Ende nuk ka vendim formal për këtë çështje.

LIGJI NË FUQI

VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rreth misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË

Neni 2 Deklarata e misionit

EULEX-i KOSOVË do t'i ndihmojë institucionet, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në punën e tyre drejt stabilitetit dhe llogaridhënies si dhe në zhvillimet e mëtutjeshme dhe forcimin e sistemit të pavarur shumetnik të drejtësisë, dhe të atij doganor, duke siguruar që këto institucione nuk do të ndikohen politikisht dhe do t'iu përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtare dhe standardeve më të mira evropiane.

Neni 3 Detyrat

Me qëllim të realizimit të Deklaratës së Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur ose duke i mbështetur autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik, dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar për lëndën apo që punon në ekipin e përzier siç përcaktohet në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it çdoherë kur konsiderohen e nevojshme do të ketë kompetencë që të siguroj administrimin e duhur të drejtësisë, të caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe me caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e

poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja.

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës

12.1 Në çdo fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një veprë penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një veprë penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë: a) një tjetër prokuror publik të Kosovës i cili punon në të njëjtën zyrë të prokurorisë, b) apo ndonjë prokuror të EULEX-it i cili do të merr përsipër hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2 Nëse kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e kryeprokurorit të EULEX-it, kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftojë kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët i cili duhet të përfillet nga kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3 Në rrethana urgjente, ose kur vonesa mund të ndikojë në kryerjen apo rezultatin e hetimit, në ndjekjen penale apo zhvillimin e drejtë të procedurave, kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmerret çdo veprim urgjent procedural, apo të caktojë cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

Ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën Kosovës

Neni 3 Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it Kosovë

...

3. Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 1.A me tekstin si në vijim:

Neni 1.A Rastet në proces e sipër

Për qëllime të këtij ligji rasti në proces e sipër nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin;
2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

.....

10. Pas nenit 7 të ligjit, shtohen dy nene të reja 7.A dhe 7.B me tekstin si në vijim:

Neni 7.A Autoriteti i prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme

Në rrethana të jashtëzakonshme një rast do t'i caktohet një prokurori të EULEX-it me vendim të përbashkët të Kryeprokurorit të Shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it KOSOVË.

Ligji nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve

Neni 136 Bazat e përgjegjësisë

1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.
2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.
3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.

.....

Neni 179 Shpërblimi i dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit

1. Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.
2. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t'i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.

.....

Neni 183 Shpërblimi në të holla

1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.
2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore

Neni 14

Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

III. ANKESAT

48. Ankuesit pretendojnë se duhet të zhvillohet një hetim nga EULEX-i rreth veprës së mundshme penale të kryer ndaj tyre. Ata pohojnë se iu ishte mohuar qasja në drejtësi dhe iu ishte refuzuar mjete ligjor apo tjetër, që do të ishte në gjendje të merrej me trajtimin e thelbit të ankesave të tyre lidhur me kushtet e këqija të jetesës dhe dëmtimit të supozuar të shëndetit dhe mirëqenies së tyre që ngritën këtu. Aplikantët bazohen në nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa).

IV. LIGJI

1. *Parashtrësat e palëve*

49. Në vërejtjet e tij fillestare të datës 2 maj 2012, ShM ka deklaruar se prokurorët e EULEX-it nuk kanë qenë të obliguar të hetojnë veprat e supozuara penale të kryera kundër banorëve romë të kampeve. Ai ka vënë në dukje se ankuesit kishin pohuar se vepra penale e “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm” (neni 365 i Gjykatës Penale të Kosovës) ishte kryer ndaj tyre. Kjo vepër nuk është shënuar në nenin 3.3. të ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjyqarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji për juridiksionin), të cilat rendisin veprat penale të cilat janë kompetencë e prokurorëve të EULEX-it. Më tej, EULEX-i theksoi se në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Kompetencat, prokurorët e EULEX-it kanë kompetenca ta marrin përsipër një hetim apo ndjekje të veprave penale, në rast se prokurorët e Kosovës nuk kanë qenë të gatshëm apo nuk kanë mundën t'i kryejnë detyrat e tyre dhe kjo mosgatishmëri ose pamundësi e tyre mund ta rrezikojë hetimin ose ndjekjen e duhur penale. Në mënyrë që të paraqitet kjo mundësi, megjithatë, së pari lënda duhet t'i referohet një prokurori publik vendor. Nëse pastaj prokurori publik vendas nuk është i gatshëm apo nuk mundet të merret me rastin, parashtruesi i ankesës mund ta njofton Kryeprokurorin e EULEX-it, i cili pastaj do të vendos nëse do t'ia caktojë lëndën ndonjë prokurori tjetër publik të Kosovës ose ndonjë prokurori të EULEX-it. EULEX-i ka argumentuar se ankuesit nuk kanë paraqitur ankesat e tyre lidhur me mosgatishmërinë e supozuar të prokurorëve për të shqyrtuar lëndën tek autoritetet vendore të ndjekjes.
50. Në përgjigjen, ankuesit kanë parashtruar se argumenti i EULEX-it që hetimi dhe ndjekja penale e krimeve kundër banorëve romë të kampeve nuk kanë qenë në kuadër të mandatit të tij ekzekutiv është e pabazuar. Sipas mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-it ka pasur për detyrë të mbroj dhe mbështetur të drejtat e njeriut në Kosovë dhe në veçanti të ndërhyjë kur aktet e kontestuara ishin të motivuara nga racizmi. Autoritetet vendore të ndjekjes së Kosovës apo autoritetet e ndjekjes së EULEX-it kishte refuzuar të fillonin një hetim dhe në lidhje me këtë kishin dështuar.

51. Ata ishin të mendimit se refuzimi i EULEX-it për të hetuar rastin kishte shkelur të drejtat e romëve sipas Konventës. Ata i referohen në veçanti neneve 6 dhe 13 të Konventës.
52. Në vërejtjet e tij të datës 20 dhjetor 2012 mbi meritat e ankesës, ShM ka mbrojtur deklaratën e tij të mëparshme.
53. Në vërejtjet e tyre mbi meritat të datës 12 nëntor 2012, ankuesit kanë përsëritur se të drejtat e tyre sipas nenit 6 të Konventës janë shkelur nga EULEX-i pasi ata nuk kishin qasje në mjete efektive ligjore. Qasja në gjykatë nuk ishte e kufizuar me ligj, por në fakt kur kryeprokurori i EULEX-it madje ka refuzuar që të merr parasysh edhe fillimin e një hetimi pa dhënë arsye aty (shih par. 43 më lartë).
54. Ankuesit më tej kanë përsëritur se neni 13 i Konventës është shkelur nga mungesa e mjetit ligjor për t'i zbatuar të drejtat e Konventës. Neni 13 ka kërkuar që autoritetet kompetente të merren me thelbin e ankesës lidhur me Konventën përkatëse dhe të ofrojnë mjetin e duhur ligjor. Mjeti ligjor i kërkuar nga neni 13 duhej të ishte efektiv, posaçërisht nuk mund të pengohej në mënyrë të pa arsyetueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve përgjegjëse. Ankuesit pohuan se ata kishin kërkuar ndihmë në pesë vende të ndryshme, por pa sukses. Kur autoritetet e Kosovës nuk kishin arritur të ofronin mjetin e duhur ligjor, përgjegjësia ka ra mbi EULEX-it për të hetuar krimet kundër aplikantëve në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tyre ekzekutive. Megjithatë, prokurori i EULEX-it nuk ka interpretuar mandatin e tij në përputhje me ligjin, por në mënyrë arbitrare ka privuar ata nga çdo shqyrtim, duke shkelur nenin 13. Për më tepër, refuzimi për të hapur hetim ka kufizuar mundësitë e ankuesve për të kërkuar dhe për të marrë kompensim në procedurën civile për shkak se ngjarjet dhe faktet nuk ishin të vërtetuara nga ndonjë hetim penal.
55. Në vërejtjet e tij të fundit të datës 24 nëntor 2014, ShM iu është drejtuar zbatueshmërisë së neneve 6 dhe 13 të Konventës për rastin në fjalë. Ai ka përsëritur se fuqitë ekzekutive që iu ishin dhënë prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it, ishin të lidhura me rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimet të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike dhe krimeve të tjera të rënda. Pra, gjendja në kampet e të zhvendosurve nuk ka hyrë në kuadër të mandatit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it. Si pasojë, nenet 6 dhe 13 nuk mund të zbatohen dhe EULEX-i nuk mund të mbahet përgjegjës për shkeljen e të drejtave të mbrojtura nga ana e tyre. Në asnjë rast, ankuesve nuk iu ishte mohuar qasja në gjykatë dhe rasti i tyre aktualisht është i pazgjidhur tek prokurorët vendorë.
56. Për më tepër, ShM ka deklaruar se ankuesit mund të iniciojnë procedurë civile dhe të kërkojnë kompensim. Sipas ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve (Ligji mbi detyrimet), kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë atë person të cilit i shkakton dëme. Më tej, Ligji për detyrimet parashikon kompensim për lëndime

fizike apo dëmtim të shëndetit (neni 179) dhe kompensim monetar në rast të dëmit jo material (neni 183). Procedura duhet të iniciohet në pajtim me ligjin nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore. Megjithatë, ai vuri në dukje se procedurat civile mund të pezullohen në pritje të procedurave penale në lidhje me padinë civile, në përputhje me nenin 14 të ligjit mbi procedurën kontestimore.

57. Në përgjigje, ankuesit kanë pohuan se ata pa sukses kishin kërkuar kompensim civil nga UNMIK-u që nga viti 2005. Ata kanë theksuar se një problem i mundshëm për iniciimin e procedurës civile për kompensim në këtë kohë është vjetërsimi. Një tjetër problem do të ishte gjetja e një ligji që ishte i zbatueshëm në rastin e tyre, pasi sistemi juridik në Kosovë ishte ende kaotik. Deri më sot, Kosova nuk posedon një ligj të njësuar civil, por pjesë të legjislationit për çështjet civile individuale, të shpërndara mbi një shumëllojshmëri të ligjeve dhe mungesa e një kuadri të përgjithshëm. Si rezultat i kësaj, të njëjtat çështje ligjore janë trajtuar në akte të ndryshme ligjore dhe shpesh në mënyrë kundërtë. Disa pjesë të mëdha të legjislationit mungonin dhe kishte nevojë për plotësimin e boshllëqeve. Këto kushte e bënë jashtëzakonisht të vështirë që të zbatohet ligjin në mënyrë korrekte. Për këto arsye, mundësitë e procedurës civile për kompensim në kuadrin ligjor ekzistues ishin shumë të vogla.

b. Vlerësimi i Panelit

58. Ankuesit pohojnë se atyre iu është mohuar qasja në drejtësi dhe nuk iu është ofruar ndonjë zgjidhje ligjore që do të ishte në gjendje për t'u marrë me thelbin e ankesave të tyre. Ata iu drejtuan neneve 6 dhe 13 të Konventës, të cilat ofrojnë këtë:

Neni 6 E drejta për një proces të rregullt

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendos qoftë për të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale ndaj tij (...).

Neni 13 E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi shtetëror, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

59. Paneli rithekson se ka shpallur të papranueshme ankesat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e supozuar të EULEX-it që dalin nga kushtet e përgjithshme të jetesës në kampin, ndotjes së mjedisit, dëme të dyshuar shëndetësore, mungesën e kujdesit të duhur mjekësor dhe dështimin për t'i zhvendosur banorët e kampi. Pra, fushëveprimi i vendimit të tij të pranueshmërisë së datës 5 tetor 2012 kufizohet në

ankesat e ankuesve në lidhje me shkeljet e pretenduara të neneve 6 dhe 13 të Konventës.

60. Paneli thekson se më 21 nëntor 2013, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka regjistruar një ankesë të parashtruar nga ankuesit. Më pas, rasti ishte caktuar një ekipi të përzier të prokurorëve të EULEX-it dhe të Kosovës. Ekipi ishte takuar më 9 janar 2014, pas së cilës prokurorit vendor i është dhënë kohë për t'u njoftuar me materialin e rastit. Përfundimisht, hetimi ishte iniciua në bazë të një vendimi të prokurorit të datës 15 prill 2014. Paneli konstaton se së pari sipas nenit 1. A (1) të ligjit nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të lidhura me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me 7 maj 2014, Misioni ka vazhduar të mbaj juridiksionin në lidhje me lëndët "që janë në proces e sipër" brenda kuptimit të kësaj dispozite. Një lëndë duhej që të konsiderohej në proces e sipër nëse një vendim për fillimin e hetimeve ishte ngritur nga prokurorët e EULEX-it para datës 15 prill 2014. Sipas këtij ligji, data në të cilën viktimat kishin parashtruar një raport tek autoritetet kompetente ishte i parëndësishëm për përcaktimin e qëllimit të këtij ligji nëse lënda ishte në proces e sipër. Pala nuk ka pasur kontroll apo ndikim mbi atë se kur do të jepej ndonjë vendim për fillimin e hetimeve.
61. Pra, pavarësisht nga fakti se ankuesit në këtë çështje kanë sjellë lëndën e tyre në vëmendjen e autoriteteve në nëntor të vitit 2013, ata nuk kanë mundur të ushtronin ndikim që lënda e tyre të konsiderohej "në proces e sipër" dhe si e tillë të mbahej nga EULEX-i.
62. Së dyti, Paneli nuk mund që të mos vënë re se nëse do të ishte marrë vendimi i prokurorit për të nisur hetimin (i marrë më 15 prill 2014) vetëm një ditë më parë, lënda do të kishte hyrë në kuadër të nocionit të lëndëve "në proces e sipër". Për këtë arsye, autoritetet e EULEX-it do të kishin mbajtur juridiksionin për të kryer hetimin e lëndës. EULEX-i nuk ka arritur të shpjegoj vendimin e vet për të mos vepruar në afatin e fundit dhe nuk ka dhënë asnjë arsye që do ta kishte penguar atë për të vepruar ashtu.
63. Në lidhje me këtë, Paneli konstaton se ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 7 maj 2014, në kontekstin e përcaktimit se cilat lëndë konsiderohen të jenë në proces e sipër ka ofruar datën e afatit të fundit në mënyrë prapavepruese. Nuk është treguar apo argumentuar se është marrë në konsideratë mënyra që zbatimi i këtij efekti prapaveprues ka dëmtuar lëndën e ankuesit.
64. Së treti, është vërejtur se në bazë të nenit 7 (A) të ligjit Nr. 04/L-273 për prokurorinë e EULEX-it ishte e mundur që të bëjë përjashtim nga parimi i përgjithshëm se rastet të cilat nuk janë konsideruar të jenë në proces e sipër, në kuptimin siç përshkruhet, duhej të trajtoheshin me autoritetet e Kosovës (shih ligjit në fuqi më lartë). Për prokurorinë e EULEX-it ishte e mundur që të marrë përsipër lëndët, nëse do të ishte

e domosdoshme prej rrethanave të jashtëzakonshme. Përsëri, EULEX-i nuk ka arritur të shpjegoj se pse, në dritën e të gjitha rrethanat përkatëse për këtë rast, ishte e arsyeshme që prokuroria e EULEX-it mos ta merrte përsipër këtë lëndë. Veçanërisht relevante me këtë ishte fakti se lënda nuk ishte hetuar siç duhej deri në atë moment. Kjo duhet ta kishte alarmuar se një dështim për të vepruar në këtë çështje mund të rezulton në privimin e viktimave nga qasja në një zgjidhje efektive ligjore.

65. Paneli më tej konstaton se kjo lëndë ka të bëjë me faktet që datojnë që nga viti 1999. Faktet e rastit *ndër të tjera* kanë të bëjnë me një prej të drejtave më thelbësore të të gjitha të drejtave themelore të njeriut, të drejtën për jetë. Kjo ka shkaktuar një numër procedurash, në të cilat banorët e kampeve kanë kërkuar ndihmë dhe kompensim nga organet dhe organizatat që ata i kanë konsideruar përgjegjës për gjendjen e tyre; mirëpo pa sukses. Po ashtu aty ka pasur edhe element të qartë etnik e natyrshme për lëndën për shkak se banorët ishin romë. Procedurat janë iniciuar para organeve të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, me qëllim të sigurimit të një forme korigjimi për banorët e kampeve, ku ka rezultuar në një numër të vendimeve, duke përfshirë edhe ato të Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut (shih paragrafët 31-35 më lartë), përsëri pa sukses.
66. Këto rrethana të marra së bashku mund të thuhet se mbajnë peshën dhe rëndësinë e duhur për të marrë parasysh nëse gjatë ushtrimit të diskrecionit prokurorial, janë marrë rrethanat e jashtëzakonshme brenda kuptimit të Nenit 7 (A) dhe nëse lënda nuk duhej të mbahet nga prokuroria e EULEX-it. Është e vërtetë se ligji i ka dhënë autoriteteve ndjekëse të EULEX-it fuqi të pakufizuar për të marrë përsipër lëndët ku ata i konsiderojnë të natyrës së jashtëzakonshme. Kjo nuk i takon Panelit të zëvendësoj autoritetet e EULEX-it në interpretimin e këtij kriteri. Megjithatë, ky diskrecion nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrare. Ajo duhet të ushtrohet me zell në bazë të të gjitha rrethanave përkatëse dhe në një mënyrë që është në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Në këtë rast, nuk ka qenë e argumentuar, e lëre më treguar, se ishte marrë në konsideratë të duhur nga autoritetet e ndjekjes së EULEX-it çështja nëse rrethanat e lëndës e kanë bërë të nevojshme që ajo të cilësohet si e jashtëzakonshme për qëllimet e këtij statuti. E as nuk është treguar se i është dhënë pesha e duhur pasojave të vendimit të tyre në të drejtat e njeriut.
67. Vendimi i Misionit që mos të nis ndonjë hetim deri pas datës së fundit të 14 prillit 2014 ka ndikuar negativisht në aftësinë e ankuesve për të kërkuar dhe marrë një ndihmë efektive ligjore për dëmin e bërë ndaj tyre. Paneli konstaton se sipas nenit 14 të ligjit 03/L-006 mbi procedurën kontestimore, gjykata është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale të marrë në procedurën penale ku i pandehuri është shpallur fajtor (shih ligjit në fuqi më lartë). Nuk ka asnjë bazë për të konstatuar se mungesa e hetimeve penale ose e një vendimi përfundimtar në një rast penal e bën të pamundur në ligj

që të kërkohet përgjegjësi civile para gjykatave civile kundër personave në lidhje me të cilët gjykatat civile të Kosovës kanë juridiksion. Megjithatë, Paneli është i mendimit se dështimi i EULEX-it për fillimin e hetimit, duke pasur parasysh seriozitetin e çështjeve në fjalë, periudhën e gjatë e cila ka kaluar që nga ngjarjet esenciale, vështirësinë për ankuesit për të marrë dëshmi në mungesë të një hetimi të tillë, ka dëmtuar në mënyrë serioze aftësinë e ankuesve për të kërkuar kompensim përmes përgjegjësisë civile dhe ka dëmtuar rëndë aftësinë e tyre për të marrë një mjet efektiv ligjor për dëmin të cilin ata kanë pësuar.

PËR KËTO ARSYE, PANELI, ME SHUMICË/NJËZËRI,

1. *Konstaton* se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës;
2. *Konstaton* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 6 të Konventës.
3. *Gjen* të përshtatshme, në bazë të gjetjeve të sipërsënuara të fakteve dhe ligjit, që të bëj rekomandimet e mëposhtme për shefin e Misionit sipas rregullës 34 të rregullores së vet të punës:
 - i. ShM duhet të udhëzojë zyrtarët kompetentë të EULEX-it të hetojnë me autoritetet e Kosovës nëse një hetim në këtë çështje është në proces e sipër dhe nëse po atëherë në çfarë fazë të procesit qëndron çështja. ShM duhet të informojë Panelin mbi rezultatin e këtij hetimi.
 - ii. Duke marrë këtë informacion, ShM duhet të udhëzojë prokurorët e EULEX-it që të marrin parasysh nëse do të marrin përsipër përgjegjësinë e këtij rasti në përputhje me nenin 7 (A) të ligjit nr. 04/L-273, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante, siç është theksuar më lartë, në veçanti nevojën që Misioni të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesve. ShM duhet të informojë Panelin mbi vendimin e prokurorisë lidhur me këtë aspekt.

Paneli kërkon nga ShM t'i ofroj Panelit informacionin e kërkuar jo më vonë se deri më datën 15 qershor 2015.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese